



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25.2.2025

Nr: 167

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “DREJTËSI INTEGRIM DHE UNITET”, ME KRYETAR Z. SHPËTIM IDRIZI, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025

Sot më datë 25.2.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1242 Prot., datë 24.02.2025, me:

- Kërkues:** Partia politike “Drejtësi Integrim dhe Unitet”, me kryetar Z. Shpëtim Idrizi
- Objekti:** Regjistrimi i partisë politike “Drejtësi Integrim dhe Unitet” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025
- Baza ligjore:** Neni 64 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë

Partia “Drejtësi Integrim dhe Unitet”, nëpërmjet Kryetarit, Z. Shpëtim Idrizi, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen më datë 11 maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 19.02.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se partia “Drejtësi Integrim dhe Unitet”, me initiale “P.D.I.U”, me Kryetar Z. Shpëtim Idrizi, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Data:25.2.2025 Nr:167
Ora:14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Drejtësi Integrim dhe Unitet”, me Kryetar Z. Shpëtim Idrizi, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025”

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Drejtësi Integrim dhe Unitet”, me shkronja nistore “P.D.I.U”, me adresë: Ruga "Nikolla Jorga", poshtë Çerdhes 47, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është Z. Shpëtim Idrizi, me adresë: Rruga "Mihal Grameno, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Zj. Ermira Lulo, me adresë: Rruga "Nikolla Jorga", poshtë Çerdhes 47, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Z. Shkëlqim Sulo, me adresë: Rruga "Nikolla Jorga", poshtë Çerdhes 47, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga partia “Drejtësi Integrim dhe Unitet”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga partia “Drejtësi Integrim dhe Unitet”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.1.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 Maj 2025”.

V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike “Drejtësi Integrim dhe Unitet”, me kryetar Z. Shpëtim Idrizi, me shkronjat nistore “P.D.I.U”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI